



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ

Numri i lëndës: 2019:133215

Datë: 22.07.2020

Numri i dokumentit: 01043499

C.nr.101/19

GJYKATA THEMELORE NE FERIZAJ- Departamenti i Pergjithshem-Divizioni Civil, me gjyqtarin Bekim Salihu, në çështjen juridike të paditësit XH.SH nga fshati ..., Komuna Shtime, të cilin me autorizim e përfaqëson avokati XH.T nga Ferizaj, kundër të paditurit D.T.SH, me adresë: rruga ..., nr....., ..., R.Serbisë, të cilin me autorizim e përfaqëson avokat M.P nga Shtërpca, në çështjen juridike vërtetim pronësie, në prani të palëve ndërgjyqëse, në seancën e mbajtur me datë 22.07.2020, merr këtë:

A K T G J Y K I M

- në bazë të pohimit -

- I. APROVOHET** si a bazuar kërkesëpadia e paditësit XH.SH nga fshati ..., Komuna Shtime, kundër të paditurit D.SH nga ..., R. Serbisë.
- II. VËRTETOHET** se paditësi është pronarë i paluajtshmërisë në parcelen kadastrale numër P- ... me sipërfaqe prej 8431m², Zona Kadastrale ..., Komuna Ferizaj.
- III.** Detyrohet paditësi që në emër të taksës gjyqësore për padi, ti paguaj në llogari të kësaj gjykate shumën prej 40€, në afat prej 15 dite nga pranimi i këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarrimit me dhunë.
-Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

A r s y e t i m i

Paditësi XH.SH nga fshati ..., Komuna Shtime, përmes të autorizuarit të tij av. XH.T nga Ferizaj, ka ushtruar padi kundër të paditurit D.T , ish nga fshati ..., Komuna Shtime, tani me adresë në ...të R.Serbisë, për vërtetimin e pronësisë.

Paditësi para fillimit të shqyrtimit gjyqësor ka bërë rregullimin e padisë në aspektin subjektiv, duke shtuar se tani e tutje në vend të paditurit D.T, tani i ndjerë, tani e tutje si i paditur do të jetë djali i tij i vetëm D.T.S nga ... në këtë çështje kontestimore.

Paditësi përmes të autorizuarit të tij ka deklaruar se mbesim pranë padisë dhe kërkesëpadisë së rregulluar në këtë shqyrtim gjyqësor për vër vërtetimin e pronësisë në ngastrën kadastrale nr...., me sipërfaqe prej 8431m², në ZK.j, ku kjo pronë është blerë në vitin 1982 sipas një kontrate të panëshkruar në shumën prej 421.530 dinarë të at'hershëm me mirëbesim të palëve, i cili çmim i është paguar në tersi palës por se një kohë të gjatë nuk kanë pasur mundësi për arsye të ndryshme dhe tani i autorizuari i D.SH, avokati M.P nga Shtërpca, ka sjellur autorizimin nga i padituri- trashëgimtari i D.T për ta bërë vërtetimin e kësaj shitblerje pa asnjë pengesë. Gjithashtu, gjykatës i dorëzoi aktvendimin mbi trashëgimin LRP.nr.1004/15, të datës 16.04.2015, si dhe deklaratën e trashëgimtarëve të gjyshit të paditësit, S.SH, gjegjësisht trashëgimtarët e J.S.SH, e vërtetuar te noteri me shenjën LRP.nr.7002/20, datës 08.07.2020 dhe deklaratën e vërtetuar te noteri me shenjën LRP.nr.7930/20, e dhënë nga vëllezërit e paditësit se nuk i kontestojnë të drejtën në parcelën nr.... në sipërfaqe prej 8431m² nga se kjo pronë është blerë para më shumë 30 viteve në ZK. Kërkesë për shpenzime të procedurës nuk ka pasur.

I autorizuari i të paditurit në fjalën përfundimtarë ka deklaruar se e pranoj në tërësi kërkesëpadinë e paditësve si të bazuar duke mos ja kundërshtuar të drejtën e pronësisë në parcelën nr.... me sipërfaqe prej 8431m² në ZK. ..., në vendin e quajtur "K...", pasi që prindi im D.T, ja ka shitur gjyshit të paditësit XH.SH, S.SH, i cili në vitin 1982, pas një marrëveshje gojore mbi shitblerjen e kësaj prone, ja ka paguar në tersi çmimin e shitblerjes dhe ka hyr në posedim në këtë pronë i pa penguar nga askush . Nuk ka pasur kërkesë për shpenzime të procedurës.

Gjykata gjatë shqyrtimit vendosi në kuptim të nen.148.1 të LPK-së, dhe mori aktgjykim në bazë të pohimit si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, meqenëse i padituri e ka pohuar kërkesëpadinë e paditëses, ndërsa nuk ka pengesa në dhënien e këtij aktgjykimi siç e përcakton nenin 148 par.2 dhe 3 pasi që e njëjta, kërkesat e palëve ndërgjyqëse nuk ka qenë në kundërshtim me nenin 3.3 të LPK-së.

Gjykata ka obliguar paditësin që në emër të taksës gjyqësore shtesë për padi të paguaj shumën prej 40€, si në dispozitiv të aktgjykimit, duke u bazuar në UA.nr.1/2017, mbi unifikimin e taksave gjyqësore.

Vendimin mbi shpenzimet e procedurës gjykata e mbështeti në nenin 450 të LPK-së, që secila palë ti bart shpenzimet e veta të procedurës.

GJYKATA THEMELORE NE FERIZAJ

C.nr.101/19, me datën 22.07.2020

**Gjyqtari,
Bekim Salihu**

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi mund të ushtrohet ankesë në afat prej 15 ditësh, pas pranimit të tij, në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, përmes kësaj gjykate.